



# BULETIN JAVOR

06-10 MAJ 2024



## PËRMBAJTJA

- AKSK pjesëmarrës në Workshop-in për Gjendjen dhe Nevojat për Sigurinë Kibernetike në Rajonin e Ballkanit
- Workshop për Mbrojtjen e Infrastrukturave Kritike dhe Sigurinë Kibernetike në Shqipëri.
- Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave organizoi takimin mbi procesin "Open Banking".
- Ndërgjegjësimi Për Mbrojtjen Online Të Fëmijëve Dhe Të Rinjve

## AKSK pjesëmarrës në Workshop-in për Gjendjen dhe Nevojat për Sigurinë Kibernetike në Rajonin e Ballkanit



Në datat 9-10 Maj Zyra Rajonale e UNDP-së në një bashkëpunim me Zyrën e UNDP-së në Shqipëri organizuan në Tiranë Workshopin për Gjendjen dhe Nevojat për Sigurinë Kibernetike në Rajonin e Ballkanit.

Në këtë event morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm i Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) Z. Igli Tafa, përfaqësues nga zyrat e UNDP-së nga vendet e Ballkanit Perëndimor, Moldavia , Gjeorgjia , Znj. Monica Merino përfaqësuese e UNDP Albania , Z. Sokol Haxhiu drejtor i Critical Infrastructure Digitalization and Resilience (CIDR) Albania si edhe përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

U diskutua mundësia e hartimit të një programi rajonal për përgjigje ndaj sfidave të sigurisë kibernetike i cili synon të ndajë njohuritë dhe përvojën në adresimin e këtyre nevojave, duke përfshirë identifikimin e sektorëve kyç për tu angazhuar dhe për tu mbështetur.

## Workshop për Mbrojtjen e Infrastrukturave Kritike dhe Sigurinë Kibernetike në Shqipëri.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve të institucioneve rregullatorë të sektorëve kritikë në Shqipëri dhe procesit të hartimit të metodologjisë së re për identifikimin e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike organizoi një workshop të fokusuar në tema që lidhen me infrastrukturën kritike, riskun kibernetik dhe vlerësimin e impaktit të incidenteve potenciale.

Në hapjen e aktivitetit, Drejtori i Përgjithshëm Z. Igli Tafa nënvizoi angazhimin e Autoritetit për mbrojtjen e infrastrukturave kritike dhe rritjen e kapaciteteve të stafëve të sigurisë kibernetike që mbulojnë sektorët kritikë. Workshop-i u realizua nga eksperti amerikan Z. Newton, i cili punon ngushtë me ekipin e Autoritetit duke ofruar ekspertizën më të mirë të fushës së sigurisë kibernetike. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin përfaqësues nga institucionet rregullatorë.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



[www.cesk.gov.al](http://www.cesk.gov.al)



@autoriteti\_kombetar\_sk



+355 422 21 039



06-10 MAJ 2024

## Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave organizoi takimin mbi procesin "Open Banking".



Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave organizoi në datën 7 Maj 2024 takimin mbi procesin "Open Banking".

Procesi "Open Banking" është një proces inovativ i cili do të facilitojë shërbime dhe pagesa për të qytetarët nëpërmjet teknologjisë. Autoriteti mbledhi bashkë të gjithë aktorët për të adresuar çështjet lidhur me procesin "Open Banking", duke theksuar përdorimin e shërbimeve të sigurta të ofruar nga ofruesi i kualifikuar i shërbimeve të besuara, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Në këtë takim morën pjesë znj. Delina Ibrahimaj, Ministër Shteti për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, z. Endrit Yzeiraj zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, znj. Luljeta Minxhozi, Zëvendësguvernatore e Parë e Bankës së Shqipërisë, znj. Mirlinda Karçanaj, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, z. Ervin Koçi Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës Financiare, përfaqësues të bankave të nivelit të dytë që operojnë në Shqipëri si dhe përfaqësues nga Fin Tech.

Takimi kishte si qëllim të adresonte çështjet lidhur me procesin e Open Banking, dhe të nxiste bashkërendimin e aktorëve për të mundur synimin e realizimit të këtij procesi deri në qershor të këtij viti.

## Ndërgjegjësimi Për Mbrojtjen Online Të Fëmijëve Dhe Të Rinjve

Në datën 9 Maj, në qytetin e Fierit, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) zhvilloi në Shkollën 9-vjeçare "Kristaq Shtëmbari", takimin e radhës ndërgjegjësuës për Mbrojtjen Online të Fëmijëve dhe të Rinjve për përdorimin në mënyrë të sigurt të internetit. Në këtë takim u përfshinë nxënësit, mësuesit, drejtoresha dhe psikologjia e shkollës.

Leksione të tilla kanë për qëllim udhëzimin e nxënësve mbi mënyrat e përdorimit të sigurtë të teknologjisë dhe internetit. Kjo përfshin këshillimin për të vepruar me kujdes në hapësirën digjitale në mënyrë që të rrisim përfitimet nga teknologjia dhe shmangien e rreziqeve të mundshme.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.cesk.gov.al



@autoriteti\_kombetar\_sk



+355 422 21 039